



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
REKTORATI

Nr. 989 Prot.

Durrës, më 12.6.2023

VENDIM

Nr 7, datë 12.6 2023

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin Nr.8480, date 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Rregulloren dhe Statutin e UAMD, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 12.06.2023;

V E N D O S I:

1. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, për planifikimin e lejes vjetore për stafin akademik për periudhën nga data 20.07.2023 deri në datën 04.09.2023.
2. Ngarkimin e Dekanëve dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, për planifikim e lejes vjetore për stafin administrativ të Universitetit " Aleksandër Moisiu" Durrës.
3. Ngrakimin Zv. Rektores, Prof.As.Dr.Renata Tokrri për hartimin e urdhërit për ngritjen e Komisionit për rekrutimin e studentëve për programet e ciklit të parë të studimeve, për vitin akademik 2023-2024.
4. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, përgjegjësve të departamenteve, për dorëzimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik, brënda datës 20.07.2023 pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë.
5. Ngarkimin e Administratorit, Z.Gerald Ceka, në marrjen e masave në bashkëpunim me autoritet lokale për zgjidhjen e problematikës së transportit të studentëve gjatë sezonit të provimeve.
6. Ngarkimin e Dekanëve në bashkëpunim me GVB, për mbarëvajtjen e procesit të akreditimit, në prezantim korrekt të programeve të studimit në proces akreditimi.

7. Ngarkimin e Dekanëve, për dërgimin e listave të studentëve të ish Filialit të Peshkopisë, të cilët janë për ç'regjistrim, duke u bazuar në relacionin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike të cilën e gjeni bashkëlidhur.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi :
- Zv.Rektorët,
 - Administratori,
 - Dekanët e Fakulteteve,
 - Përgjegjësit e Departamenteve,
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike,
 - Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë.

R E K T O R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKAE SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
SEKTORI I SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 368/prot.
5

Durrës më 12/6 2023

Lënda:

Kthim përgjigje për kërkesën për hartimin e një relacioni për çregjistrimin e studentëve që kanë kaluar më shumë se dyfishin e kohëzgjatjes normale të studimeve për Filialin e Peshkopisë

REKTORES
PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI

E nderuar,

Në vijim të kërkesës suaj "Kërkesë për relacion" për çregjistrimin e studentëve që kanë kaluar më shumë se dyfishin e kohëzgjatjes normale të studimeve, për ish filialin e Peshkopisë sqarojmë si më poshtë vijon:

Bazuar në ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" në nenin 90 përcaktohet se :

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.
2. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studime brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj.

Sqarojmë se përcaktimet e këtij ligji mbi kohëzgjatjen e programeve të studimit zbatohen për studentët që nisin studimet pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Ministria e Arsimit me shkresën nr 1090 prot., datë 13.11.2014 urdhëron me Urdhërn. 442, datë 12.11.2014 "Për mbylljen e Filialit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në qytetin e Peshkopisë, studentët që vazhdojnë studimet, si dhe studentët përsëritës, të këtij filiali, në programet e studimit, me kohë të plotë apo të pjesshme, kalojnë në njësitë kryesore të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës. Për të kryer të gjitha ndryshimet organike dhe institucionale që rrjedhin nga mbyllja e këtij filiali brenda datës 31.03.2015, sipas legjislacionit në fuqi.

Pas këtij urdhëri Ministria del sërish me një urdhër tjetër për shtyrjen e afatit të mbylljes së këtij filiali konkretisht Urdhër nr.125, datë 27.03.2015 i Ministres së Arsimit dhe Sportit “Për disa ndryshime në urdhrin nr.442, datë 12.11.2014 “Për mbylljen e Filialit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në qytetin e Peshkopisë”. Për të kryer të gjitha ndryshimet organike dhe institucionale që rrjedhin nga mbyllja e këtij filiali *brenda datës 31.07.2015.*

Studentë të regjistruar për herë të parë në ish filialin Peshkopi rezultojnë në vitin akademik 2009-2010 dhe brezi fundit i studentëve të regjistruar rezultojnë në vitin akademik 2013-2014 në të gjitha format e studimit që parashikonte ligji vjetër për arsimin.

Në referim të Ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi në kohën e regjistrimit të studentëve të Ish filialit Peshkopi përcaktohet kohëzgjatja normale sipas programeve të studimit.

Institucionet e arsimit të lartë kanë për detyrë të hartojnë dhe miratojnë statutet dhe rregulloret e tyre, në përputhje me ligjin e kohës. Në referim të statutit dhe rregullores së UAMD-së për kohën në nenin 26 pika 1 të statutit të UAMD miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr 13.dt 24.03.2011 përcaktohej se: “... Studimet universitare të ciklit të parë realizohen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike..... Gjithashtu ofrohen edhe programe të studimeve që realizohen me 120 kredite me kohëzgjatje normale jo më pak se 2 vite akademike... ***Kohëzgjatja maksimale e programeve të studimit të ciklit të parë është dyfishi i kohëzgjatjes normale.....***

Në kreun VI neni 30 përcaktohej se: *Studenti e fiton cilësinë si i tillë me regjistrimin në universitet dhe e humbet me marrjen nga ana e tij të diplomës universitare, ose të dëshmisës së kualifikimit, me përjashtimin nga shkolla ose me nënshkrimin e kërkesës për ç’regjistrim nga universiteti .*

Në rregulloren e UAMD-së për kohën miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr.35 datë 07.09.2012 në nenin 37 pika 2 përcaktohej se: ***“Kohëzgjatja maksimale e programit të studimit është dyfishi i kohëzgjatjes normale”.***

Në nenin 62 përcaktohej se: “Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe humbet me marrjen e diplomës *si dhe në raste të ndryshmetë ç’regjistrimit të tij të parakohshëm.....*”

Në nenin 64 përcaktohej se :

1. Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës.
2. *Statusi hiqet përpara afatit kur studentit ç’regjistrohet, në këto raste:*
 - a) Me urdhër të dekanit, bazuar në kërkesën e studentit për ç’regjistrim në formën e një deklarate;
 - b) Me urdhër të dekanit kur vërtetohet se i kanë munguar ose ka humbur kushtet dhe kriteret për të drejtën e studimit;
 - c) Kur braktis studimet pa shkak dhe pa ndjekur procedurat për ndërprerjen e studimeve;
 - d) Me urdhër të dekanit, pas konsultimit me këshillin përkatës të studentëve për shkelje të rëndë ose të përsëritur të kësaj Rregulloreje ose rregullores së brendshme të fakultetit ku ai është regjistruar.

Në përfundim sugjerojmë se për procedurat e çregjistrimit për studentët të cilët kanë nisur programet e studimit para hyrjes në fuqi të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i përfundojnë ato sipas kriterëve dhe modaliteteve të legjislacionit të kohës kur këta studentë janë pranuar.

Duke ju falenderuar,

DR. DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
BLERINA KOKA

